

# Program për zhvillimin e Fakultetit Ekonomik të UKZ në periudhën 2019-2023

Nga: Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi – kandidat për Dekan të Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik të Gjilanit, “Kadri Zeka”.


## 1. Programet studimore – orientimi strategjik

Në kuadër të zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, UKZ, dhe në kuadër të tij Fakulteti Ekonomik, duhet të përshtatë programet studimore për nevojat e tregut të punës, përkatësisht industrisë dhe administratës publike.

Duke pasur parasysh këto nevoja, e sidomos duke u mbështetur në hulumtime për nevojat dhe kërkesat e tregut të punës (From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Kosovo\* - Doc i KE 2016) si dhe konkurrencën (kryesisht nga universitetet tjera publike por edhe kolegjet private), orientim strategjik për zhvillimin e Fakultetit Ekonomik për këto katër vite të cilat do të krijojnë bazë edhe për periudhën e më pastajme është që programet të **orientohen nga NDËRMARRËSIA dhe INOVACIONI** me dy qasje:

- përgatitje për tregun e punës;
- përgatitje për studime të mëtejshme.

Ky orientim strategjik mund të shihet në mënyrë të përmblendhur në skemën në vazhdim



Nga skema më sipër shohim se Fakulteti Ekonomik për këtë fazë katër vjeçare duhet të profilizohet në dy programe baze studimore me pesë profile të specializimi në nivelin bachelor si dhe fillimisht me një program masteri me tri profile specializimi.

### ***Dinamika orientuese e realizimit të skemës programore***

- Viti akademik 2019/20 aplikohet për akreditimin e programit Menaxhment dhe Ndermarrësi në të dy nivelet, bachelor dhe master
- Viti akademik 2020/21 aplikohet për akreditimin e programit Finance dhe Kontabilitet  
*\*Nëse plotësohen kushtet për nr të stafit, këtë vit aplikohet edhe për akreditimin e programit të dytë master - Finance e Kontabilitet me specializimet (orientimisht): Ekonomiks financiar; Tregu financiar dhe institucionet; Kontabilitet.*
- Viti 2023/24 – të aplikohet për një **program te doktoratës**-( si fakultet Ekonomik i UKZ apo në bashkëpunim me ndonjë fakultet simotër në Kosovë apo jashtë saj).

## 2. Bashkëpunimi me punëdhënësit (sektorin privat dhe administratën publike)

Do të vendoset një komunikim i ngushtë dhe i vazhdueshëm me bizneset dhe institucionet publike, me të cilët do të bashkëpunohet për :

- hartimin e kurrikulës së programeve të studimit që do të përgatisin studentë me kompetenca që i kërkon tregu i punës.
- organizimin e praktikave profesionale (intership) për studentet që ta plotësojnë pjesën teorike me atë praktike

Për realizimin e këtij objektiv do të fillohet të punohet menjëherë dhe intensivisht qysh me fillimin e vitit të ri akademik 2019/20 dhe ekziston projekt ideor konkret.

## 3. Cilësia akademike dhe kërkimore

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie do të jetë preokupim i vazhdueshëm për çka fokusi do të jetë në dy drejtime themelore:

- Cilësia akademike
  - Seriozitet dhe rregull në respektimin e orarit dhe obligimeve tjera për stafin akademik me qëllim kryesor realizim të procesit akademik të kualitetit të lartë;
  - Organizim të aktiviteteve (projekteve) trajnuese dhe të ngjashme për aplikimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore që ngritin aftësitë dhe shkathtësitë për mësimdhënie dhe punë kërkimore shkencore.
  - Krijimi i hapësirës dhe mundësive për ngritjen dhe avancimin e asistentëve drejt përgatitjes së tyre për nivele më të larta akademike dhe kërkimore.
- Kërkimi shkencor
  - Realizim të aktiviteteve kërkimore shkencore duke angazhuar dhe studentët
  - Organizimin vjetor të një konference shkencore dhe botimin e një reviste shkencore.

## 4. Themelimi i Institutit të Fakultetit

Gjatë vitit akademik 2019/2020 duhet të themelohet Instituti i Fakultetit Ekonomik me qëllim që përmes tij të realizohet komponenti kërkimor - shkencor si një nga dy shtyllat kryesore të funksionimit të Fakultetit.

Ky institut do të mbështesë realizimin e qëllimeve të vendosur në dy pikat paraprake. Përmes projekteve kërkimore shkencore dhe bashkëpunimit me industrinë dhe administratën publike (lokale dhe qendrore), Fakulteti Ekonomik do të bëhet referencë për ndihmën që do tu jep këtyre sektorëve në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të tyre dhe zgjidhjen e problemeve biznesore apo të politika zhvillimore.

Po ashtu Instituti do të vendos bashkëpunim me donatorë ndërkombëtar që mbështesin kërkimin shkencor si dhe ata që mbështesin biznesin apo administratën publike në mënyrë që të mundësojë realizimin më të mirë të tyre.

## 5. Bashkëpunimi me studentët

Për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të vendosura në dy pikat e mësipërme do të duhet një bashkëpunim më i ngushtë dhe i vazhdueshëm me Këshillin studentor dhe studentët duke i bërë ata pjesë të procesit të zhvillimit dhe duke marrë parasysh idetë, propozime, vërejtjet, preokupimet dhe shqetësimet e tyre. Për këtë qëllim, përpos aktiviteteve shtesë në funksion të realizimit të projekteve të ndryshme, do të ketë takime në baza të rregullta.

## 6. Bashkëpunimi i brendshëm (intra & inter) dhe i jashtëm

Në këtë pikë orientimi dhe angazhimi është që:

- të ndërtohen një klimë bashkëpunuese brendapërbrenda stafit të Fakultetit
- të ndërtohet një klimë bashkëpunimi dhe koordinim për realizimin e projekteve të përbashkëta me fakultete të tjera brenda UKZ
- në bashkëpunim me Menaxhmentin dhe zyrat përkatëse të intensifikohet bashkëpunimi me fakultete simotra brenda dhe jashtë Kosovës me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve.
- Për stafin dhe studentët të mundësohet pjesëmarrje në programe dhe projekte rajonale e ndërkombëtare etj.

Për realizimin e këtij programi do të bazohem në qasjen e re të menaxhimit publik, që është - **MENAXHIMI I BAZUAR NË REZULTATE!**

Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi

Dt.18.05.2019

Gjilan